



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN

Nr. 4103 Prot.

Elbasan, më 16.07. 2026

Vendim

Nr. 70 Datë 16.07/2026

Për përcaktimin e detyrave, përgjegjësiave dhe kompetencave

Me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të aktivitetit administrative të administratës së Bashkisë dhe rritjen e efikasitetit të saj, bashkërendimin e aktivitetit të strukturave në realizimin e funksioneve dhe shërbimeve publike, bazuar në ligjin 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” nenet 8,9, 59 e 64 të tij, ligjin 44 datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, nenet 28 e 29 të tij,

Vendosa

- 1- Zv/Kryetari i Bashkisë z. Renato Haxhiaj, është përgjegjës për drejtimin, organizimin e punës, ndarjen e detyrave, kontrollin dhe monitorimin, e aktivitetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Kujdesit Social, Arsimit, Rinisë dhe Sportit, Agjencia e Shërbimeve Sociale, si dhe Drejtoria e përgjithshme e Arsimit Parauniversitar.
- 2- Në funksion të realizimit të përgjegjësiave si më sipër, Zv/Kryetarit z. Renato Haxhiaj i delegohen kompetencat si më poshtë:
 - *Të kontrollojë, shqyrtojë dhe nënshkruaj të gjithë korespondencën e krijuar dhe aktet e nevojshme administrative, në funksion të realizimit të përgjegjësiave të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi.*
 - *Kontrollon, miraton e nënshkruan materialet që paraqiten në Këshillin Bashkiak, si relacione, projekt-vendime etj, që kanë lidhje me ushtrimin e përgjegjësiave të përcaktuara në këtë urdhër dhe merr masat e nevojshme për zbatimin e vendimeve të tij.*
- 3- Aktet dhe shkresat zyrtare të dala në zbatim të kompetencave të sipërcituara, do të jenë njelloj të detyrueshme, për administratën e Bashkisë dhe njësitë vartëse të saj.
- 4- Ushtrimi i këtyre kompetencave do të bëhet nga data 16.07.2026 deri në një urdhër të dytë.
- 5- Zv Kryetari z. Renato Haxhiaj nuk mund të delegojë këto kompetenca tek punonjës apo struktura të tjera.
- 6- Zv/kryetari z. Renato Haxhiaj do të raportojë periodikisht, por jo më rrallë se një herë në muaj, për realizimin e detyrave të përcaktuara në këtë vendim.

- 7- Ngarkohen zv/kryetari z. Renato Haxhij dhe administrata e Bashkisë me zbatimin e këtij vendimi si dhe Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit dhe Medias me publikimin e tij.
- 8- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Bashkisë.

Kryetari
Gledian Llatja

A circular official stamp of the Municipality of Elbasan (Bashkia e Elbasanit) is visible. The stamp features the coat of arms of Elbasan in the center and the text "REPUBLIKË E SHQIPËS" at the top and "BASHKIA E ELBASANIT" at the bottom. A handwritten signature in black ink is written over the stamp.